

DERI TE :

KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR I FAKULTETIT FILOZOFIK

Në bazë të vendimit *Nr. 16-158/2* të datës **24.03.2026** të Këshillit mësimor Shkencor të Fakultetit Filozofik, për formimin e Komisionit për vlerësimin e punimit të paraqitur për punimin e disertacionit të doktoraturës, si dhe në bazë të nenit 201 të Statutit të Universitetit të Tetovës dhe nenit 62 të *Rregullores për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhe studimit në ciklin e tretë të studimeve-studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës*, komisioni në përbërje: **1. Prof. Dr. Ibish Kadriu, anëtar, 2. Prof. Dr. Abdynaser Sinani, anëtar, 3. Prof. Dr. Qani Nesimi, anëtar, 4. Prof. Dr. Ardita Abduli Reka, anëtar, 5. Prof. Dr. Metush Sulejmani, mentor**, pasi vlerësoi projekt propozimin e tezës së doktoraturës: **“Ndërtimi i diskursit religjioz në shoqërinë kosovare gjatë vitit 2000-2020”**, të kandidatit **Mr. sc. Nexhmedin Ademi**, paraqet këtë:

RAPORT

për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

Të dhëna biografike të kandidatit

Mr.sc.Nexhmedin Ademi ka lindur më 1973 në fsh.Coroticë komuna e Preshevës.

Arsimimi: Shkollimin e fillor e ka kryer në vendlindje kurse të mesmen në Medresenë “Alaudin” në Prishtinë. Më 1996 kryen fakultetin e studimeve islame në Prishtinë.kurse më 2013 në Universitetin e Tetovës në Tetovë ka kryer master shkencor nga sociologjia kulturore me temë:”Aspekte sociokulturore dhe historiografike të identitetit evropian të shqiptarëve në proceset integruese”.Në vitin 2020 i regjistron studmet e doktoraturës -cikli i tretë në Universitetin e Tetovës -Maqedonia e Veriut,drejtimi Sociologji e Kulturës.

Përvoja profesionale:Myfti i Bashkësisë Islame për Preshevë,Bujanoc dhe Medvegjë, drejtor i shoqatës kulturore “Dituria” në Preshevë, mësimëdhënës i lëndës fetare në shkollat publike 2002-2006, administrator në Këshillin e Bashkësisë Islame në Preshevë.

Aktivite akademike dhe shkencore: Ka marr pjesë në konferenca shkencore në Shqipëri, Mal të Zi dhe Preshevë, ka bërë prezantime në fushat: arsimit fetar, identiteti kulturor, integrimi evropian.

Projekte dhe trajnime: Ka qenë drejtues i Shkollës Verore 2016. Drejtues i seminarit "Promovimi i liderëve të rinj" Durrës, pjesëmarrës në program rinor në Zagreb (YTB)

Botime dhe angazhime: Kryeredaktor i revistës "Identiteti", kryeredaktor i "Takvimi", botues i revistës "Freskia" bashkëpunëtor në revistën "Shenja".

1. Analizë e punimit të disertacionit të doktoraturës me titull: "Ndërtimi i diskursit religjioz në shoqërinë kosovare gjat vitit 2000-2020"

Informacione lidhur me lëndën e hulumtimit

Hulumtimet bashkëkohore mbi religjionin përfshijnë rëndësinë e tij si në kontekstin historik ashtu edhe në atë bashkëkohor. Këto studime, vazhdojnë ta konsiderojnë fejen si një nga elemente kyçe të strukturës shoqërore e cila në brendësinë e saj përmbanë vlera etike, të drejtësisë etj. të cilat luajnë rol të madh në organizimin shoqëror. Në këtë kërkim shkencor kandidati Nexhmedin Ademi, do të hulumtoj aspektet socio – kulturore të religjionit si formë e vetëdijes shoqërore gjegjësisht mënyrat se si është formuar dhe përdorur diskursi fetar në shoqërinë kosovare gjat periudhës 2000 – 2020. Nëse i marrim parasysh format zyrtare të diskursit në media, politikë dhe përfaqësimin në opinionin publik, ky disertacioni i doktoraturës synon të shpjegoj rolin e diskursit fetar, simbolikën e tij në rrjedhat e ndërtimit të identitetit, mobilizimit shoqëror dhe legjitimitit të pushtetit. Në këtë punim vëmendje të veçantë iu kushtohet komuniteteve fetare, të myslimanëve, katolikëve dhe ortodoksëve në shoqërinë kosovare, përfaqësimit institucional të tyre, pozicioni i mediave, roli i tyre dhe ndikimi i prezencës ndërkombëtare në modelimin e diskursit fetar në opinionin publik etj. Element kyç i këtij punimi të doktoratës është se synon të tregoj se si feja përdoret për të ruajtur unitetin shoqëror të grupeve me përkatësi të ndryshme identitare, religjioze etnike etj. Qëllimi i këtij studimi ka për qëllim të afirmoj nevojën e ndërtimit të një ambienti gjithëpërfshirës ku botëkuptimi mbi fenë të përfshihet në shoqërinë kosovare pa u përplasur me rregullimin kushtetues sekular të shtetit të Kosovës. Nga përmbajtja e këtij studimi vërehet kjo që qëllimi i këtij studimi është të paraqesë udhëzime për unifikimin e kulturave fetare me identitetin nacional dhe shoqëror të shoqërisë kosovare. Sipas këtij studimi komunitetet fetare nuk duhet të instrumentalizohen por ato duhet të përfshihen në ambientin politik dhe kulturor të vendit

ku veprojnë, duke u bërë faktorë i stabilitetit në dobi për të mirën e të gjitha komuniteteve religjioze dhe civile në mjedisin ku jetojnë

Informacione lidhur me gjendjen në fushën shkencore në të cilën është punuar disertacioni

Edhe pse problematika e këtij disertacioni është shumëdimensional dhe multidimensional, megjithatë kandidati këtë problematikë e ka hulumtuar në kuadër të sociologjisë së kulturës duke e potencuar gërshetimin e elementit social dhe kulturor të religjionit si formë e vetëdijës shoqërore i cili në shoqëri zen një vend të rëndësishëm.

Edhe pse në shoqërinë kosovare ka patur përpjekje të natyrave të ndryshme që të hulumtohet kjo problematikë, megjithatë ato janë parciale dhe nuk e plotësojnë vakumin shkencor të cilin e kërkon bota bashkëkohore. Në këtë drejtim kandidati Nexhmedin Ademi me këtë disertacion të doktoraturës "Ndërtimi i diskursit religjioz në shoqërinë kosovare gjat vitit 2000-2020" ka dhënë një kontribut të madh në plotësimin e këtij vakumi shkencor duke nxjerrë në pah shumë vlera të cilat do jenë profitabile edhe për disiplinat tjera shkencore.

2. Qëllimi dhe arsyet e hulumtimit

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi shkencor fokusohet në analizat teorike sociologjike të diskursit fetar në Republikën e Kosovës. Pjesë e këtij qëllimi është dekonstruktimi i gjuhës dhe mënyra e artikulimit të identitetit të komunitetit në lidhje me shtetin dhe shoqërinë kosovare. Përmes këtij dekonstruktimi komunitetet fetare do të vendosin identitetin e tyre fetar i cili është në shërbim të shtetit, atëdheut, sigurinë e mirëqenies shoqërore etj. Në këtë mirëqenie shoqërore bëjnë pjesë siguria dhe stabiliteti familjar, roli i komunitetit fetar në luftën kundër dukurive sociopatologjike të cilat padyshim që ndikojnë në ngritjen e vetëdijës dhe ndërgjegjes njerëzore për një jetë më të shëndoshë.

Studimi i kësaj problematike synon që:

- Të analizon dhe studion formimin, ndryshimet dhe përdorimin e diskursit fetar në kuadër të konteksteve politike, shoqërore dhe kulturore të Kosovës,
- Të ofroj një pasqyrë teorike dhe empirike se si diskursi fetar kontribon në krijimin e identiteteve kolektive, marrëdhënieve ndërmjet komunitetit dhe narrativave politike,

- Të ofroj një kornizë teorike të problemit duke u bazuar në analizën poststrukturaliste të diskursit dhe teoritë e identitetit,
- Të ofroj një analizë komparative midis religjionit dhe hapësirës publike,
- Të ofroj lehtësi në hulumtimin e indikatorëve nga fusha e fesë, jeta institucionale dhe mjetet e komunikimit masiv,
- Të ofroj mundësi dhe qasje për ta kuptuar se si ndikojnë këto indikator në definimin e diskursit publik mbi fenë, cilat janë perceptimet kryesore dhe burimet ideologjike që mundësojnë formimin e përkatësive fetare dhe mënyren se si instrumentalizohen këto narracione për qëllime politike.

3. Metodologjia e hulumtimit

Në këtë disertacion doktore është shfrytëzuar një qasje e kombinuar metodologjike që në vehte ngërthen metoda dhe teknika kualitative dhe kuantitative të cilat sigurojnë hulumtim shkencor të religjionit dhe elementeve tjera të strukturës shoqërore të shoqërisë kosovare.. Nëpërmjet metodës së analizës së përmbajtjes si qasje sasiore (kuantitative) janë mbledhur, krahasuar, analizuar dhe përpunuar informacione, analiza apo trajtime nga mediat në Kosovë, si rrjete sociale, media elektronike dhe media të shtypura. Kandidati ka përdorur një sërë metodash, teknikash dhe instrumente tjera metodologjike të cilat e ngrisin lartë validitetin dhe përmbajtjen e këtij punimi shkencor. Nga aspekti metodologjik qasja analitike e hulumtimit bazohet kryesisht në metodën kualitative. Kjo qasje metodologjike përfshinë aspekte të ndryshme të cilat ofrojnë mundësi të përdoren koncepte teorike për hulumtimin e diskursit fetar si rast kërkimor në lidhje me qasjet kulturore, etnografike, dallimet racore, gjinore, sociale, konceptet identitare, modelimi i diskurseve kulturore, politike, fetare etj. Ndërsa me ndihmën e analizës të përmbajtjes cilësore janë përpunuar 54 deklaratat ose intervista të njohësve të problemit dhe ekspert të fushës, sipas intenzitetit, shpeshësisë së nocioneve, terminologjisë dhe koncepteve të shfrytëzuara për të përshkruar diskursin dhe rrjedhat fetare në kontekst të frymës politike, pranimit ose përjashtimit fetar në periudhën 2000–2020. Punimi i disertacionit është bazuar në qasjen e kombinuar kualitative-kuantitative, e cila shërben në të njëjtën kohë për të analizuar kuptimet e diskursit dhe matjen e tij sipas metodës kuantitative të hulumtimit. Dimenzioni cilësor i referohet analizës interpretative të diskursit fetar, ndërsa dimenzioni sasior përfshin analizën frekuencore të shfaqjes së kategorive fetare. Një qasje e këtillë metodologjike është e pranuar, pasi analiza e përmbajtjes

mundëson si kuptimin cilësor, ashtu edhe kodimin sasior të të dhënave. Analiza dhe paraqitja kuantitative e të dhënave përmes grafikëve në kuadër të qasjes metodike e teorike shërben, për plotësimin e analizës kualitative, duke qenë se analiza e përmbajtjes lejon si interpretimin e kuptimeve, ashtu edhe zbatimin e tyre në nivel teorik. Nga ana metodologjike, përmbledhja analitike e hulumtimit shërbehet me metodën kualitative. Kjo metod përmbledh apekte të ndryshme, që shprehin pikëpamjet mbi drejtësinë shoqërore, perspektivat ideologjike, idet filozofike, e deri te procedurat e veprimit sistematik. Gjatë këtij disertacioni janë përdorë gjithashtu metoda përshkruese, komperative, intervista jo të strukturuar. Me ndihmën e metodës induktive, dhe deduktive, janë nxjerrë përfundimet dhe supozimet e mundshme. Studimi përdor gjithashtu mënyra hulumtimi të mbështetura në studime krahasuese të literaturës teorike si dhe të studimeve kërkimore shkencore të mëparshme. Studimet nga fusha e historisë, etnografisë, eseve të autorëve, intervistave, deklaratave të autorëve dhe figurave të bashkësive fetare, artikulet e ideve të integritit, orientimeve kulturore dhe debateve identitare rreth fesë, e cila shihet si një mundësi për orientim kulturor e kalimit nga perëndimi drejt lindjes, interpretohen me qëllim përshkrimi, zbulimi të kuptimeve, dekonstruktiv të gjuhës dhe gjenerim të kuptimeve të reja, si dhe për ndërtimin e hipotezave me synim arritjen e përfundimeve të cilat do t'ju shërbejnë qëllimeve dhe objektivave të studimit, si dhe njohurive të reja për të kuptuar thelbin e diskursit fetar në kontekste dhe situata të caktuara shoqërore. Metoda bazike me të cilin është shërbyer ky hulumtim është analiza e përmbajtjes, e kombinuar me qasje kualitative dhe kuantitative. Analiza e përmbajtjes shërben për kërkimin shkencor konstant të materialit komunikues (teksteve mediatike dhe deklaratave), duke përfshirë për lëndë studimi evidentimin e kategorive, njësive të analizës dhe mostrës. Analiza e përmbajtjes si teknika e përdorur në këtë disertacion është mbledhja e publikimeve mediatike përmes seleksionimit të dhënave sipas standardeve të parapërcaktuara si tema, aktorët dhe periudha kohore. Kjo ka mundësuar sistematizimin dhe matjen sasore të dhënave, duke siguruar njëkohësisht përputhshmëri metodologjike midis qasjes sasore/kuantitative dhe paraqitjes cilësore/kualitative të rezultateve. Aspekti empirik i punimit shqyrton tematikën e publikimeve mediatike, ku qëndrimet janë përcaktuar në indikatorë operacionalë përmes kodimit të përmbajtjes.

Mostra e hulumtimit

Mostra e analizuar përbëhet nga 240 publikime mediatike të cilat ka mbledhur dhe analizuar kandidati nga mediat në Kosovë, si rrjetet sociale, mediate elektronike, podkasatet me ndikim në një periudhë kohore të përcaktuar, nga viti 2000 deri në vitin 2020. Kurse me ndihmën e analizës cilësore të përmbajtjes janë analizuar 54 deklarata si intervista me njohës dhe ekspert të diskursit dhe zhvillimeve fetare në shoqërinë kosovare në periudhën 2000–2020.

4. Argumentimi i hipotezave të hulumtimit

Korniza e hipotezave t

Hipoteza kryesore

Diskursi religjioz në media dhe në mjediset politike në Kosovë në të shumtën e rastave karakterizohet nga qasja ekskluzive dhe qasje konfliktuozë. Diskursi fetar në shoqërinë kosovare në periudhën e viteve 2000 - 2020 është ndikuar nga komponentë të shumtë socialë e kulturorë. Supozimi ndërlihet nga dinamika e ndryshimeve politike, si edhe dallimit fetar e kulturor midis strukturës shumë konfesionale dhe shumë etnike në Kosovë.

b. Hipotezat ndihmëse:

-Diskursi religjioz në media dhe në mjediset politike në Kosovë në të shumtën e rastave ka karakteristika ekskluzive dhe konfliktuozë.

- Aktorët politikë përdorin më shpesh diskurs fetar negativ në krahasim me atë neutral ose pozitivë.

- Mediat kontribuojnë në riprodhimin e stereotipizimit të komuniteteve fetare në komunitetet e tyre.

Hipoteza ndihmëse: “Diskursi mediatik nuk prezanton në mënyrë objektive bashkësitë religjioze, duke kontribuar në stigmatizimin dhe marginalizimin e tyre”. Kjo hipotezë synon të argumentojë se diskursi fetar në mediat e shkruara dhe vizive në opinionin publik nuk pasqyron objektivisht rolin dhe kontributin e disa komuniteteve fetare gjatë proceseve të

zhvillimit kulturor dhe historik të Kosovës. Disertacioni përmes kësaj hipoteze synon të argumentoj se disa komunitete fetare janë cenzuruar nga përfshirja në opinionin publik. Siç mund të vërehet ndaj tyre është projektuar ekspozimi mediatik me imazh negativ. Kjo hipotezë shërben për të kuptuar se si modelohen diskurset fetare dhe si duket impakti i tyre në zhvillimet shoqërore dhe politike në Kosovë.

Qëllimet e hulumtimit

Çdo periudhë shoqërore në këtë mjedis përcjelllet me ndryshime të shumta shoqërore. Këto ndryshime kërkojnë një hulumtim më të detajuar kualitativ të diskursit fetar në shoqërinë kosovare. Analiza e këtij hulumtimi, synon të përcaktoj modelet e komunikimit, temat kryesore dhe referencat ideologjike që ndikojnë në perceptimin e fesë në opinionin publik, duke iu referuar hulumtimit të diskursit mbi opinionet fetare. Analiza e hulumtimit më tepër ndalet te roli i institucioneve fetare, zhvillimeve politike dhe mjetet e komunikimit masiv në modelimin e diskursit fetar. Një nga synimet e këtij disertacioni është të analizoj dinamikën e ndërtimit të diskursit fetar brenda komuniteteve fetare në raport me shtetin e Kosovës. Do të tentohet të shpjegohet se secila prej bashkësive fetare ndërton marrëdhënien e saj me shoqërinë në mënyra të ndryshme. Studimi synon ta përshkruajë (ta shpjegoj, ta sqaroj, ta mbështesë dhe ta argumentoj) këtë marrëdhënie, duke theksuar pasqyrimin e këtij diskursi në jetën e përditshme shoqërore, politike dhe kulturore.

Qëllimi i studimit është të shpjegoj se bashkësitë fetare duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë. Dekonstruktimi i përdorimit të gjuhës së komuniteteve në raport me opinionin publik do të zbuloj rrezikun nga supozimi për superioritetin e statusit të një feje ndaj një tjetre. Kjo përpjekje për t'i dhënë përparësi një komuniteti ndaj komunitetit tjetër rrezikon tolerancën fetare dhe destabilizon kohezionin shoqëror, i cili është nën ndikimin e orientimeve kulturore të bazuara në prejardhjen apo origjinën e atyre feve.

Studimi synon të theksojë se një qasje e tillë mund të pengoj jetën integruese dhe të rrisë ndjenjën e inferioritetit të një komuniteti. Një qasje përjashtuese ndaj një komuniteti mund të hapë mundësi për dezintegracion social në sferën shoqërore kosovare, duke mos përjashtuar mundësinë e paraqitjes së pengesave për integrim në nivel kombëtar.

Qëllimet e kryesore të hulumtimit

Kandidati Mr.sc.Nexhmedin Ademi në punimin e tij të doktoraturës paraqet disa qëllime kryesore të cilat, të ndërlidhura me pyetjet kërkimore,punimit i japin një përmbajtje shkencore afirmative psh:

- Bashkësitë fetare në Kosovë nuk janë një pengesë për unitetin shoqëror.
- Të shikohet dhe të mirret parasyshërrreziku i përdorimit të fesë për motive politike dhe kulturore.
- Shteti duhet të garantoj koekzistencën ndërmjet feve, ai duhet t'i siguroj status të barabartë shoqëror.
- Të argumentohet se fetë nuk janë pengesë për politikat e integritit të shoqërisë kosovare në vlerat e komunitetit evropian.
- Të dëshmohet se autoktonia e feve krahas identitetit shtetëror të Kosovës, duhet të promovoj patriotizmin dhe dashurinë për atdheut.
- Të dëshmohet se origjina e bashkësive fetare nuk duhet të përdoret për agjenda që minojnë sovranitetin e shtetit.
- Stigmatizimi ndaj çdo bashkësie krijon inferioritet ndaj shtetit.
- Të shqyrtohet niveli i përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe intolerancës ndërmjet bashkësive fetare.
- Sekularizmi dhe laicizmi si vlerë shoqërore nuk nënkuptojnë defetarizimin e shoqërisë.etj.

Në funksion të hipotezave, në këtë studim synohet t'u jepet përgjigje pyetjeve kërkimore të ngritura si më poshtë:

- A ka opinionin publik të njëjtin qëndrim ndaj bashkësive fetare?
- A duhet të ndihen inferiorë shumica myslimane në raport me shoqërinë dhe opinionin publik për shkak të përkatësisë së tyre fetare?
- A kanë myslimanët në Kosovë arsye të stigmatizohen për dhunën dhe urrejtjen që përhapin grupet ekstremiste dhe individë brenda bashkësisë myslimane në Kosovë?

-A hasen përbërës të identitetit kombëtar në komunitetin mysliman shqiptar që lidhin përkatësinë e këtij komuniteti me identitetin shtetëror?

-A favorizojnë idetë për integrimin evropian bashkësinë katolike për shkak të idesë se Evropa ndan vlera të ngjashme të krishtera me identitetin e kësaj bashkësie?

-Si interpretohen idetë dhe deklaratat mbi “rënjë të krishtera” të identitetit të shqiptarëve, dhe sa ndikojnë në rrezkimin e tolerancës fetare?

-A po artikullohet identiteti ortodoks i serbëve për të refuzuar pjesëmarrjen e këtij komuniteti në jetën institucionale të Kosovës?

-A mund të hasen zëra brenda komunitetit ortodoks serb që e pranojnë realitetin ri politik të shtetit të Kosovës?

-Si ndikon qasja teorike e unifikimit të përkatësisë ortodokse me identitetin kulturor nacional serb, respektivisht përdorimi i koncepteve metafizike ortodokse për shenjtërimin e historisë ku Kosova konsiderohet “tokë e premtuar” për serbët?

Motivet dhe arsyet që e kanë nxitur realizimin e këtij hulumtimi ndërlidhen drejtëpërdrejt me mënyrën se si realizohen proceset shoqërore në shoqërinë kosovare dhe si ato reflektohen në fenomenin e religjionit ,siç janë psh:

- funksionimi juridiko-politik i shtetit,
- funksionimi ekonomik,
- funksionimi kulturor,
- funksionimi mediatic dhe
- marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërfitare në Kosovë.

5. Kontributet shkencore të hulumtimit

Rëndësia e këtij hulumtimi me titull “Ndërtimi i diskursit religjioz në shoqërinë kosovare gjatë vitit 2000-2020” është i një rëndësie të veçantë dhe thelbësor për shkencën dhe infrastrukturën akademike të shoqërisë kosovare e më gjërë. Padyshim që religjioni si formë e vetëdijes shoqërore ka një rol të shumëfishtë në shoqëri. Ai është pjese e strukturës shoqërore e cila e ka

ndikimin e vet në mbarëvajtjen e proceseve shoqërore. Përmes këtij hulumtimi vërehen kjo vlerat pozitive të religjionit në shoqëri siç janë kontributi i tij në kohezionin social, ndërtimin e identitetit individual dhe grupor, ndërtimin e marrëdhënieve ndëretnike në shoqëritë shumetnike siç është shoqëria kosovare, ngritjen e vetëdijës etiko-morale e cila ka pasoja pozitive në sistemin arsimor, ekonomik dhe administrativ e medial. Duke i marrë parasysh këto vlera të religjionit në shoqëri, mund të thuhet se këtu qëndron kontributi shkencor i këtij disertacioni i cili mbulon një vakum të madh shkencor në kuadër të shkencave shoqërore e veçanërisht në shkencën e sociologjisë. Ky hulumtim krijon një bazë dhe referencë të fuqishme për hulumtime të mëtejshme në kuadër të shkencave shoqërore e cila do të jetë një vlerë e shtuar në sferën shkencore dhe akademike.

6. Pritjet shkencore të hulumtimit

Ky punim i doktoraturës në aspektin strukturor të tij ka pjesën e sajë teorike dhe kornizën metodologjike. Pjesa teorike e punimit mbështetet në dimenzionin konceptual të hulumtimit dhe elaborimit të religjionit, gjegjësisht ndërtimin e diskursit fetar në shoqërinë kosovare në raport me elementet tjera të strukturës së shoqërisë. Kurse ana metodologjike përqëndrohet në operacionalizimin e anës teorike në praktikë duke ndërtuar përmbajtje kohezive mes këtyre dy pjesëve të këtij disertacioni. E gjithë kjo pritet të rezultoj me një unifikim të të dhënave në forma të ndryshme të cilat në përfundim punimit i japin kuptim dhe përmbajtje shkencore. Përmbajtja e këtyre vlerave rezulton si një studim dhe hulumtim sociologjik i llojit të vet e cila përfshinë një periudhë të caktuar dhe shumë të rëndësishme të shoqërisë kosovare e cila është pjesë imanente e proceseve shoqërore të kësaj shoqërie. Objektivi i këtij studimi ndërlidhet me sqarimin e faktorëve strukturor siç janë: ai ekonomik, politik, etnik, kulturor, mediatik etj, të cilat nxisin ndërtimin e diskursit fetar. Në këtë drejtim, duke i marrë parasysh kushtet dhe rrethanat historike të ndërtimit të këtij diskursi fetar, pritet që hulumtimi të ofroj një studim dhe qasje sociologjike e cila i nxjerr në pah ndryshimet shoqërore dhe dinamikën e këtyre proceseve shoqërore ku vend të caktuar ka edhe religjioni dhe ndërtimi i diskursit fetar në kuadër të proceseve globaliste e postmoderniste. Ky studim pretendon që në ndërtimin e diskursit fetar ta përforcoj dimenzionin sociologjik që kjo problematike të mbetet pjesë e Sociologjisë së religjionit. Padyshim që ky studim i ka arritur këto objektiva:

- Përforcimi i komponentes sociologjike gjat hulumtimit të ndërtimit të diskursit fetar,
- Mbulimi i vakumit shkencor e veçanrisht atij sociologjik të religjionit i cili do të jet një ndihmesë e madhe për shkenctarët e kësaj fushe e veçanrisht për hulumtuesit e rinjë,
- Nxjerrjen në pah të multidimensionalitetit të religjionit dhe diskursit fetar të tij etj.

7.Fusha shkencore e hulumtimit

Disertacioni i doktoroturës së kandidatit Nexhmedin Ademi punuar dhe realizuar nga fusha e sociologjisë së kulturës dhe religjionit që në përmbajtjen e tij ngërthen edhe elemente tjera të strukturës shoqërore siç janë aspekti socio-ekonomik, politik, mediatk dhe kulturor i shoqërisë kosovare. Struktura e punimit: Hyrja e cila është një përshkrim i shkurtër i hulumtimit i cili paraqet arsyet dhe qëllimet pse është i rëndësishëm ky studim në kohë tranzicioni. Në kapitullin e parë bëhet fjalë për qasjen metodologjike të hulumtimit e cila ndërlidhet me hipotezat, qëllimet dhe detyrat shkencore, mostrën si dhe metodat dhe instrumentet hulumtuese të cilat paraqesin kornizën metodologjike për hulumtimin e problematikës së ndërtimit të diskursit fetar në shoqërinë kosovare. Në kapitullin e dytë vend qendror zen analiza e diskursit e cila zbërthehet përmes analizës kritike të diskursit, qasjes etnografike, analiza e fetarisë së përditshme, analiza narrative, qasja semiotike e diskursit etj, dhe përfundon me diskursin publik, diskursin fetar dhe interferimi i raportit komparativ mes fesë dhe shtetit. Kapitulli i tretë ka të bëjë me ndërtimin e diskursit fetar në shoqërinë kosovare i cili specifikohet përmes identitetit fetar dhe orientimit gjeopolitik i cili në vehte përmban katolicizmin, ortodoksizmin, sekularizmin, feja dhe heteogjeniteti etnik i shoqërisë kosovare, islami radikal (selefizmi, tekferizmi si sfida shoqërore dhe institucionale për diskursin publik). Kapitulli i katërt trajton orientimet strategjike të diskursit fetar dhe ate përmes katolikocentrizmit, miti mbi perendimin dhe diskursi përjashtues ndaj tjetrit në shoqërinë kosovare, etj. Kapitulli i pestë përqëndrohet në përpunimin e raportit triadik: diskursi fetar- mediat dhe jeta politike duke prezentuar qëndrimet mediatike të grupimeve politike,

manipulimin politik dhe rolin e liderëve fetar. I gjithë ky raport triadik përmblihet duke nxjerr përfundime të cilat mbështeten nga të dhënat teoriko empirike apo kualitativo-kuantitativ. Në këtë pesë të punimit paraqiten të dhëna të cilat flasin kjo për mënyrën se si faktori ekonomik, politik kulturor dhe medial ndikojnë në ndërtimin e diskursit fetar në shoqërinë kosovare. Kapitulli i gjashtë përqëndrohet në përpunimin e diskursit mbi pluralizmin fetar i cili si koncept ka të bëjë me tolerancën e cila nënkupton njohjen aktive të dallimeve, dialogun ndërmjet komuniteteve dhe bashkëjetesën pa dominim. Në pjesën përfundimtare jepen koncepte përmbledhëse dhe sugjerime se si përdoret feja në shoqëri si një mjet diskursiv në proceset e ndërtimit shoqëror të identitetit, legjitimitetit të pushtetit politik dhe formësimit të narrativit publik. Ky disertacion doktorature ka arritur ta konfirmoj kornizën hipotetike përmes pyetjeve të parashtruara shkencore duke përcaktuar kjo faktorët të cilët ndikojnë në ndërtimin e diskursit fetar në shoqërinë kosovare.

Vlerësim dhe rekomandim

Duke u bazuar në vlerësimet e lartpërmendura, Komisioni shkencor për vlerësimin e punimit të doktoraturës me titull "Ndërtimi i diskursit religjioz në shoqërinë kosovare gjat vitit 2000-2020" të kandidatit Mr.sc. Nexhmedin Ademi ka nderin që ti propozoj Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve për mbrojtjen publike të këtij disertacioni të doktoraturës.

Komisioni:

1. Prof. Dr. Ibish Kadriu - anëtar

2. Prof. Dr. Abdylnaser Sinani - anëtar

3. Prof. Dr. Qani Nesimi - anëtar

4. Prof. Dr. Ardita Abdul Reka - anëtar

5. Prof. Dr. Metush Sulejmani - mentor

